


## Annex F: Përshkrimi i Pronave të Konfiskuara nga Krimi i Organizur, subjekt i Thirrjes për Projekt-Propozime

### 1. “Lokal” me sip. 174 m<sup>2</sup> në lagjen nr.1, rruga ” Taulantia”, Durrës

Objekti - “Lokali” me sipërfaqe 174 m<sup>2</sup> ndodhet në bodrumin e një godine ezistuese në Lagjen nr. 1, Rruga “Taulantia”, Durrës. Kjo pronë ndodhet paralel me aksin kryesor të rrugës dhe ka shumë lëvizje kalimtarësh pasi aksi lidh segmentin që të çon tek Currilat dhe në qendër të Durrësit. Godina ndodhet 200 m larg bregut të detit. Që prej vitit 2017 pasuria e konfiskuar është nën administrimin e AAPSK. Pasuria ka nevojë për rikonstruksion. [Planimetria](#).

### Foto të pasurisë





## 2. Bodrum me sip. 85 m<sup>2</sup>, në Elbasan

Objekti – “**Bodrum**” me sip. 85 m<sup>2</sup> është bodrumi i një pallati që ndodhet në rrugën “Ismail Zyla”, rreth 150 m larg universitetit “Aleksander Xhuvani”, në Elbasan. Objekti ka një derë hekuri të jashtme dhe ka nevojë për rikonstruksion. Që prej vitit 2017 pasuria e konfiskuar është nën administrimin e AAPSK. [Planimetria](#).

Foto të pasurisë



## 3. “Garazh” me sip. 48.1 m<sup>2</sup> në Sarandë.

Objekti – “**Garazh**” me sip. 48.5 m<sup>2</sup> gjendet në katin përdhe të pallatit dhe është e përshtatur si apartament. Dera e jashtme e blinduar, dyshemeja e shtruar me pllaka, dera e dhomës prej druri, dera e tualetit dur-alumin, dritaret dur alumin, instalimet elektrike të rregullta. Që prej vitit 2005, pasuria e konfiskuar është nën administrimin e AAPSK. Pasuria ka nevojë për rikonstruksion. [Planimetria](#)

Foto të pasurisë

